In addition to the Events of Default (under, and as defined in, the Senior Facilities Agreement), the occurrence of any of the following events or conditions constitutes a default hereunder and is herein referred to as an "Event of Default":

|   |  |
|---|--|
| <p>(a) Barrëdhënësi nuk përmbush çdo lloj detyrimi, duke përfshirë pa asnjë kufizim mospagimin e kryeqjesë, interesave apo shuma të tjera që përbëjnë pjesë të Detyrimeve të Siguruara të papaguara në kohën e duhur;</p> <p>(b) keqinterpretimi thelbësor nga ana e Barrëdhënësit në cilëndo marrëveshje ose transaksion ndërmjet Barrëdhënësit dhe Palëve të Siguruara në lidhje me marrëdhënien e kreditimit sipas Marrëveshjes së Huasë siguruar me këtë Marrëveshje;</p> <p>(c) falimentimi ose mungesa e aftësisë paguese të Barrëdhënësit, njoftimi kundër Barrëdhënësit i procedurave të falimentimit;</p> <p>(d) çdo proces gjyqësor që bëhet i ekzekutueshëm kundër Barrëdhënësit apo Kolateralit, i cili (Event) sipas mendimit të arsyeshëm të Barrëmarrësit, mund të çenojë aftësinë e Barrëdhënësit për të përmbushur Detyrimet e Siguruara;</p> <p>(e) cilado palë e tretë kërkon të ekzekutojë një tjetër barrë siguroese ose peng mbi Kolateralin;</p> <p>(f) Barrëdhënësi ndërpret apo paralajmëron se do të ndërpresë veprimtarinë e tij tregtare ose bie dakord për të disponuar pasuritë ose një pjesë të konsiderueshme të tyre pa njoftuar Barrëmarrësin;</p> <p>(g) sipas mendimit të Barrëmarrësit, mbi baza të arsyeshme tregtare, Barra Siguroese ose Pengu është i rrezikuar.</p> | <p>(a) the Chargor fails to perform or observe any obligations, including, without limitation, the non-payment of any principal, interest, or other amount forming part of the Secured Obligations when due;</p> <p>(b) the Chargor has made a substantial misrepresentation in any agreement or transaction between the Chargor and the Secured Parties relating to the credit relationship according to the Senior Facilities Agreement secured by this Agreement;</p> <p>(c) the Chargor becomes insolvent or an insolvency petition against the Chargor has been filed;</p> <p>(d) any court process of and that becomes enforceable against Chargor or the Security, which according to the reasonable opinion of the Chargee, may impact the capacity of the Chargor to fulfill the Secured Obligations;</p> <p>(e) any third party seeking to enforce another securing charge or pledge over the Security;</p> <p>(f) the Chargor's cease or threatening cease of carrying on business or making or agreeing to dispose of the assets or a substantial portion thereof without notice to the Chargee;</p> <p>(g) in the opinion of the Chargee, upon commercially reasonable grounds, the Securing Charge or the Pledge is jeopardized or endangered.</p> |
| <p><b>6.2 PËRSHPEJTIMI</b></p> <p>Në Rast Mospërmbushjeje dhe në çdo kohë më pas, Barrëmarrësi nga ana e tij mund të deklarojë një pjesë ose të gjitha Detyrimet e Siguruara që nuk konsiderohen të pagueshme me anë të kërkesës, të bëhen menjëherë të tilla pa kërkesë apo njoftim të çdo lloji.</p> <p><b>6.3 MJETET LIGJORE NË RAST MOSPËRMBUSHJEJE</b></p> <p>Në Rast Mospërmbushjeje, plus të drejtave dhe mjeteve ligjore të tjera që mund të ketë sipas ligjit, Barrëmarrësi mund:</p> <p>(a) të zgjedhë të mbajë të gjithë apo një pjesë të Kolateralit në përmbushje të Detyrimeve të Siguruara të Barrëdhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje në mënyrën e parashikuar në Ligjin për Barrët Siguroese dhe Kodit Civil;</p>   | <p><b>6.2 ACCELERATION</b></p> <p>Upon the occurrence of an Event of Default and at any time thereafter the Chargee in its sole discretion may declare all or any part of the Secured Obligations that are not by their terms payable on demand, to be immediately due and payable, without demand or notice of any kind.</p> <p><b>6.3 REMEDIES IN CASE OF AN EVENT OF DEFAULT</b></p> <p>Upon an Event of Default, the Chargee may, in addition to any other rights and remedies it may have according to the law:</p> <p>(a) elect to retain all or any part of the Security in satisfaction of the Secured Obligations of the Chargor under this Agreement then outstanding as provided in the Securing Charges Law and the Civil Code;</p>  |



(b) të sekuestrojë, arketojë, ekzekutojë, shesë, japë me qira, të marrë para hua për të siguruar dorëzimin e Kolateralit tek palët e treta ose të veprojë me Kolateralin apo një pjesë të tij në mënyrë të tillë, sipas kushteve dhe termave të tilla, dhe në kohën që lejohet nga Ligji për Barrët Siguruese dhe Kodi Civil; si dhe mund të kërkojë në emër të tij dhe t'u paguajë të tjerëve shuma për shpenzimet e marra përsipër në mënyrë të arsyeshme dhe për shërbimet e kryera në lidhje me marrjen, arkëtimin, kryerjen, marrjen e huasë për sigurimin, shitjen e Kolateralit ose fitimin e pagesave nga ai dhe mund t'ia shtojë sasinë e këtyre shumave borxhit që Barrëdhënësi ka ndaj Barrëmarrësit;

(c) të vazhdojë të ekzekutojë pagesat dhe të ushtrojë të drejtat dhe mjetet ligjore të Barrëmarrësit për të cilat parashikohet në Ligjin për Barrët Siguruese dhe Kodin Civil, si dhe të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore në dispozicion të Barrëmarrësit të cilat nuk bien në kundërshtim me legjislacionin shqiptar.

#### 6.4 MJETET LIGJORE JO-PËRJASHTUESE

Të gjitha të drejtat, fuqitë dhe mjetet ligjore të Barrëmarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje mund të ushtrohen në veçanti ose të kombinuara dhe nuk zëvendësojnë, por janë shtesë e çdo forme sigurimi në vazhdim nga Barrëmarrësi dhe të gjitha të drejtat e tjera, fuqitë apo mjetet ligjore të Barrëmarrësit, pavarësisht nga forma se si kanë lindur apo janë krijuar.

#### 6.5 PËRGJEGJËSIA PËR MUNGESAT

Për sa kohë është në përputhje me ligjin e zbatueshëm, Barrëdhënësi mbetet përgjegjës për përmbushjen e çdo Detyrimi të Siguruar që nuk është përmbushur plotësisht ose shlyer nga dhënia e të ardhurave që lindin nga zbatimi i Barrës Siguruese dhe Pengut kundrejt Kolateralit/Detyrimeve të Siguruara.

#### 6.6. MBARIMI I BARRËS SIGURUESE

6.6.1 Barra Siguruese e vendosur Kolateral sipas Nenit 2, ne cdo rast, mbetet në fuqi derisa të gjitha Detyrimet e Siguruara të jenë paguar pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme dhe të jenë çliruar plotësisht. Ajo regjistrohet me një afat fillestar prej 10 vjet duke filluar nga data e regjistrimit të kësaj Marrëveshjeje Siguruese pranë Regjistrimit të Barreve Siguruese me të drejte rinovimi të këtij regjistrimi nga ana e Bankes, derisa të gjitha Detyrimet e Siguruara të jenë paguar pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme dhe të jenë çliruar plotësisht.

6.6.2 Barra Siguruese do t'i lirohet Barrëdhënësit vetëm pasi të gjitha Detyrimet e Siguruara të jenë paguar pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme dhe

(b) seize, collect, enforce, sell, lease, borrow money on the security of release to third parties, or otherwise deal with the Security or any part thereof in such manner, upon such terms and conditions, and at such time or times as permitted by the Securing Charges Law and the Civil Code; and may charge on its own behalf and pay to others sums for expenses reasonably incurred and for services rendered in connection with seizing, collecting, enforcing, borrowing for insuring, or selling the Security, or obtaining payments from it and may add the amount of such sums to the indebtedness of the Chargor to the Chargee.

(c) proceed to enforce payment and exercise any of the rights and remedies of the Chargee provided for in the Securing Charges Law and the Civil Code, as well as any and all other rights and remedies possessed by the Chargee that are not disallowed by any law of Albania.

#### 6.4 NON-EXCLUSIVE REMEDIES

All rights, powers, and remedies of the Chargee under this Agreement may be exercised separately or in combination and shall be in addition to, and not in substitution for, any other security now or hereafter held by the Chargee and any other rights, powers, and remedies of the Chargee, however created or arising.

#### 6.5 LIABILITY FOR DEFICIENCY

Subject to applicable law, the Chargor shall remain liable for the performance of any Secured Obligation that is not fully satisfied or discharged by the application of the proceeds arising from the enforcement of the Securing Charge and Pledge against the Security/Secured Obligations.

#### 6.6. DURATION PERIOD OF THE SECURITY

6.6.1 The Securing Charge provided under Article 2, in any case, remains in effect until all the Secured Obligations have been unconditionally and irrevocably paid and discharged in full. It is registered with an initial term of 10 years starting from the date of registration of this Securing Charge Agreement at the Securing Charge Registry with the right renewal of this registration by the Bank until all the Secured Obligations have been unconditionally and irrevocably paid and discharged in full.

6.6.2 The Security shall be released to the Chargee only after all the Secured Obligations have been unconditionally and irrevocably paid and discharged

të jenë çliuar plotësisht, gjë që do të rezultojë edhe në çregjistrimin nga Regjistri i Barrëve Siguruese nga Agjenti i Garancive, secila në ngarkim të Barrëdhënësit.

**ENI 7  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**7.1 VAZHDIMËSIA E GARANCISË**

Kjo Marrëveshje dhe Barra Siguruese e krijuar sipas saj nuk zëvendësojnë por konsiderohen si shtesë e barrëve të tjera siguruese të mbajtura nga Barrëmarrësi, dhe konsiderohet një Marrëveshje në vazhdimësi dhe Barrë Siguruese dhe Peng deri kur përfundon me shkrim dhe nënshkruhet nga palët.

**7.2 KOMUNIKIMI**

7.2.1 Kur çdonjërs nga palët i kërkohet apo i jepet e drejta të njoftojë, t'i drejtohet ose t'i bëjë një kërkesë palës tjetër, ky njoftim, drejtim apo kërkesë duhet të jetë me shkrim dhe quhet i mjaftueshëm vetëm kur i dorëzohet fizikisht kësaj palë, i dërgohet me postë të thjeshtë tek kjo palë, në adresën e përcaktuar më poshtë ose në atë të ndryshuar, me kusht që ndryshimi i adresës t'i jetë raportuar palës tjetër në mënyrën e përcaktuar më sipër.

7.2.2 Çdo komunikim nga secila palë do të dërgohet në adresat dhe kontaktet e përcaktuara më poshtë:

**Për Agjentin e Garancive:**

Kontakt: Znj. Juljana Leka  
Juljana.Leka@raiffeisen.al  
Adresa: Rruga e Kavajës, Tiranë, Shqipëri

**Për Barrëdhënësin:**

Kontakt: Fatos Kaleshi  
Adresa: Rruga Dervish Hima  
Pallati Ambasador 3, Kati, Apartamenti 3  
ZK. Nr. 8160, Tiranë, Shqipëri

7.2.3 Për secilën metodë të dorëzimit, data dhe koha përkatëse e dorëzimit kur dorëzimi i njoftimit konsiderohet se është kryer me kusht që të gjitha kërkesat e tjera në këtë klauzolë të jenë përmbushur:

| Metoda e dorëzimit | Data dhe ora kur dorëzimi quhet i kryer |
|--------------------|---|
| Dorëzimi dorazi    | Me nënshkrimin e një fletë-dërgese.     |

in full, which shall also result in the deregistration from the Security Charge Register by the Security Agent, each at the cost of the Chargor.

**ARTICLE 7  
GENERAL PROVISIONS**

**7.1 CONTINUING SECURITY**

This Agreement and the Securing Charge created hereby are in addition to and not in substitution to any other securing charge now hereafter held by the Chargee and is intended to be a continuing Agreement and Securing Charge and Pledge until terminated in writing and signed by the parties.

**7.2 COMMUNICATION**

7.2.1 Wherever either party hereto is required or entitled to notify or dire the other or to make a demand or request upon the other, such notice, direction, demand, or request shall be in writing and shall be sufficiently given only if physically delivered to the party for whom it intended or sent by mail addressed to the party for whom it is intended to the address of such party as set forth below or as changed provided that such a change of address is delivered to the other party in the manner hereinabove set forth.

7.2.2 Any communications by either party shall be sent to the addresses and contacts shown below:

**For the Security Agent:**

Contact: Mrs. Juljana Leka  
Juljana.Leka@raiffeisen.al  
Address: Rruga e Kavajës, Tirana, Albania

**For the Chargor:**

Contact: Fatos Kaleshi  
Address: Rruga Dervish Hima  
Pallati Ambasador 3, Kati, Apartamenti 3  
ZK. Nr. 8160, Tirana, Albania

7.2.3 For each delivery method, the corresponding delivery date and time when delivery of the notice is deemed to have taken place provided that all other requirements in this clause have been satisfied:

| Delivery method   | Deemed delivery date and time       |
|-------------------|-------------------------------------|
| Delivered by hand | On signature of a delivery receipt. |



Korrier ndër-kombëtar i regjistruar

Koha e regjistruar nga shërbimi i dorëzimit.

International recorded courier

At the time recorded by the delivery service.

### 7.3 PASARDHËSIT DHE CESIONARËT

Kjo Marrëveshje duhet të jetë e detyrueshme për Barrëdhënësin dhe pasardhësit e tij dhe duhet të sigurojë që është në favor Barrëmarrësit, pasardhësve të tij dhe cesionarëve. Kjo Marrëveshje është e cedueshme (transferueshme) lirisht nga Barrëmarrësi tek çdo palë e tretë (cesionar), dhe Barrëdhënësi nuk ka të drejtë t'i kundërvihet cesionarit apo të ngrejë ndaj tij pretendimet që ai ka ndaj Barrëmarrësit.

### 7.4 PRANIMI I OPCO-s

Opcos pranon detyrimet, garancitë, përfaqësimet, angazhimet dhe premtimet e Barrëdhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe pranon të mos ndërmarrë asnjë veprim që mund të dëmtojë ose pengojë zbatimin e tyre.

### 7.5 PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E BERZH

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të interpretohet si heqje dorë, refuzim ose modifikim tjetër i ndonjë imuniteti, privilegji ose përjashtimi të BERZH, të akorduar sipas Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, konventës ndërkombëtare ose ndonjë ligji të zbatueshëm.

## NENI 8 REGJISTRIMI I BARRËS SIGURUESE DHE PENGUT

8.1 Sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast brenda 3 (tri) ditëve pune nga Data Efektive e Garancisë, Barra Siguruese do të regjistrohet në Regjistrin e Barrëve Siguruese nga Barrëdhënësi, në zbatim të Ligjit për Barrët Siguruese dhe një vërtetim i krijimit të Barrës Siguruese mbi Kuotat i lëshuar nga Regjistri i Barrëve Siguruese do t'i dorëzohet Agjentit të Garancive nga Barrëdhënësi.

8.2 Sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast brenda 3 (tri) ditëve pune nga Data Efektive e Garancisë, Pengu do të regjistrohet në Regjistrin Tregtar nga **Barrëdhënësi**, si edhe në regjistrin e kuotave të shoqërisë, në përputhje me nenin 547 të Kodit Civil dhe një kopje e noterizuar e faqes së regjistrimit të shoqërisë, e cila dëshmon këtë regjistrim të Pengut, i dorëzohet Agjentit të Garancive nga **Barrëdhënësi**.

8.3 Opcos autorizon Agjentin e Garancive që të ekzekutojë, dorëzojë, regjistrojë dhe depozitojë çdo dokument tjetër që Agjenti i Garancive konsideron të

### 7.3 SUCCESSORS AND ASSIGNS

This Agreement shall be binding on the Chargor and its successors and shall ensure to the benefit of the Chargee and its successors and assigns. This Agreement shall be freely assignable by the Chargee to any third party (assignee), and the Chargor shall not assert against such an assignee of the Chargee any claim or defence that the Chargor has against the Chargee.

### 7.4 ACCEPTANCE OF OPCO

Opcos accepts the obligations, warranties, representations, engagements and promises of the Chargor under this Agreement and agrees not to take any action that might undermine or prevent their implementation.

### 7.5 PRIVILEGES AND IMMUNITIES OF EBRD

Nothing in this Agreement shall be construed as a waiver, renunciation or other modification of any immunities, privileges or exemptions of EBRD accorded under the Agreement Establishing the European Bank for Reconstruction and Development, international convention or any applicable law.

## ARTICLE 8 REGISTRATION OF THE SECURITY CHARGE AND PLEDGE

8.1 As soon as possible, but in any event within 3 (three) business days from the Security Effective Date, the Securing Charge shall be registered by the Chargor in the Securing Charge Register, pursuant to the Securing Charges Law, and an attestation of the creation of the Securing Charge over the Shares issued by the Securing Charges Registry shall be delivered to the Security Agent by the **Chargor**.

8.2 As soon as possible, but in any event within 3 (three) business days from the Security Effective Date, the Pledge shall be registered in the Commercial Registry by the Chargor, as well as in the shareholders' register of the company, pursuant to article 547 of the Civil Code, and a notarized copy of the page of the shareholders' register of the company evidencing such registration of the Pledge shall be delivered to the Security Agent by the Chargor.

8.3 Opcos hereby authorizes the Security Agent to execute, deliver, register and file any further documents that the Security Agent considers



nevojshëm ose të përshtatshëm, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, cilëndo transfertë që bëhet sipas Marrëveshjes së Huasë tek një Kredidhënës i Ri. Opco do të ekzekutojë, dorëzojë, regjistrojë dhe deponojë dokumente të tilla dhe të kryejë veprime të mëtejshme që Agjenti i Garancive mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të ndikuar në qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, për të përsosur dhe siguruar vëzhdimin e Barrës Siguruese dhe Pengut, për të mbrojtur dhe ruajtur Kolateralin dhe për të zbatuar të drejtat e Bankës.

### ENI 9 VERIFIKIMI DHE RAPORTIMI I TË DHËNAVE

9.1 Palët në këtë Marrëveshje bien dakord dhe deklarojnë me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë se informacioni i dhënë prej tyre është i vërtetë, i saktë dhe i plotë dhe bien dakord dhe deklarojnë si vijon:

9.2 Duke kuptuar se të dhënat demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë do të trajtohen në përputhje me dispozitat ligjore që korrespondojnë me mbrojtjen e të dhënave personale, sekretit bankar dhe profesional, si dhe duke kuptuar se Raiffeisen Bank sh.a dhe Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar trajtimin e sigurt të të dhënave tona, *i japim pëlqimin tonë të plotë, të lirë Raiffeisen Bank sh.a, për qëllimet që përfshijnë:*

- i. vlerësimin e aplikimit për të marrë kredi;
- ii. vlerësimin e rrezikut të kredisë përgjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies të kredisë me Raiffeisen Bank sh.a;
- iii. vlerësimin e besueshmërisë së përfaqësuesve të autorizuar të Barrëdhënësit ose pronarëve përfitues përfundimtarë si persona të lidhur me Barrëdhënësin;
- iv. informimin mbi detyrimet tona ndaj institucioneve financiare kredidhënëse, nëpërmjet përpunimit të autorizuar të të dhënave të Regjistrit të Kredive, për të vlerësuar vlerën e ekspozimit kreditor në Sistemin Bankar e Financiar, garancitë dhe besueshmërinë/ aftësinë për të shlyer detyrimet financiare.

9.3 Gjithashtu, japim pëlqimin tonë që Banka (Raiffeisen Bank sh.a) të përdorë emrin tonë dhe të dhënat tona identifikuese dhe financiare, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë.

9.4 Ne jemi informuar siç duhet për të drejtat tona për të kërkuar informacion mbi të dhënat tona gjatë periudhës së ruajtjes së tyre nga Raiffeisen Bank sh.a., si dhe për t'i korrigjuar/rishikuar në rastet kur ato janë të pasakta, të paplota. Për këtë qëllim, jemi të

necessary or appropriate, including but not limited to any transfer being made under the Senior Facilities Agreement to a New Lender. Opco shall execute, deliver, register and file such documents and do such further acts as the Security Agent may reasonably request in order to affect the purposes of this Agreement, to perfect and ensure continuation of the Securing Charge and the Pledge, to protect and preserve the Security and to enforce the Bank's rights hereunder.

### ARTICLE 9 VERIFICATION AND DATA REPORT

9.1 Parties to this Agreement agree and declare with their full and free will that the information provided by them, is true, accurate and complete and they agree and declare as follows:

9.2 Having realized that demographic and financial data stored in the Credit Registry of the Bank of Albania will be handled in accordance with legal provisions corresponding to protection of personal data, banking and professional secret and also having realized that Raiffeisen Bank sh.a. and Credit Registry of the Bank of Albania have taken all necessary measures to ensure the safe handling of our data, *we provide our full, free consent to Raiffeisen Bank sh.a., for the purposes that include:*

- i. assessing the application to obtain credit;
- ii. credit risk assessment throughout the duration of credit relationship with Raiffeisen Bank sh.a.;
- iii. assessment of the Chargor's authorized representatives' or ultimate beneficial owners' credibility as persons related to the Chargor,
- iv. to be informed on our obligations towards crediting financial institutions through authorized processing of the Credit Registry data, in order to assess the amount of credit exposure in the Banking and Financial System, warranties and reliability/ability to repay financial obligations.

9.3 Also, we give our consent to the Bank (Raiffeisen Bank sh.a.), to use our name and our identifying and financial data, to perform standard and mandatory reporting to the Credit Register of the Bank of Albania.

9.4 We have been duly informed on our rights to request information on our data during their retention period by Raiffeisen Bank sh.a., as well as to correct/revise in cases when they are inaccurate, incomplete. For such purpose, we are aware that any



vetëdijshëm se secila nga kërkesat e mësipërme mund t'i drejtohet Raiffeisen Bank si më poshtë:

- Në vëmendjen e Personit Përgjegjës për Raiffeisen Bank sh.a, të cilit mund t'i adresohen pretendimet mbi të dhënat e raportuara.
- Emri/Adresa: Znj. Juljana Leka  
Rruga e Kavajës, Tiranë, Shqipëri
- E-mail: [rba.dataprotection@raiffeisen.al](mailto:rba.dataprotection@raiffeisen.al)
- Telefoni: +355698022250
- Faqja e internetit: <https://www.raiffeisen.al/>

9.5 Deklarojmë se i kemi lexuar me kujdes dhe e kemi kuptuar përmbajtjen e kësaj klauzole të pëlqimit paraprak dhe njohim pasojat përkatëse ligjore në lidhje me përpunimin e të dhënave tona personale, informacionit financiar dhe/ose çdo informacioni tjetër rreth nesh në cilësinë e përfaqësuesve të autorizuar ose pronarëve përfundimtarë të Barrëdhënësit dhe për këtë arsye unë e nënshkruaj këtë dokument me vullnetin tim të plotë dhe të lirë.

9.6 Ky autorizim konsiderohet i dhënë për të gjithë personat nënshkrues të Marrëveshjes, pra si për përfaqësuesit e autorizuar, ashtu edhe për pronarët përfundimtarë të Barrëdhënësit dhe të dhënat e tyre.

#### NENI 10 TË NDRYSHME

10.1 Kjo Marrëveshje do të zbatohet dhe do të interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar.

10.2 Barrëdhënësi autorizon Barrëmarrësin të regjistrojë formularët e njoftimit të regjistrimit dhe dokumente të tjerë dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet që Barrëmarrësi mendon se janë të përshtatshme për të plotësuar dhe vazhduar Barrën Siguruese, për të mbrojtur dhe ruajtur Kolateralin dhe për të ekzekutuar Barrën Siguruese, duke përfshirë por pa u kufizuar në cilëndo transfertë që bëhet sipas Marrëveshjes së Huasë tek një Kredihënës i Ri.

10.3 Kjo Marrëveshje lidhet sipas Marrëveshjes së Huasë dhe është e detyrueshme si për palët nënshkruese, ashtu dhe për personat që mund të zënë vendin e tyre ose të cilëve u janë transferuar të drejtat apo detyrimet.

10.4 Palët mund të ndryshojnë vetëm me shkrim elementët e kësaj Marrëveshje dhe t'i pasqyrojnë ato në regjistrat përkatës.

10.5 Mosmarrëveshjet e palëve lidhur me këtë Marrëveshje do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pavarësisht sa më sipër, BERZH nuk i nënshtrohet dhe nuk do t'i nënshtrohet juridiksionit të gjykatave shqiptare në bazë të imuniteteve, privilegjeve ose përjashtimeve të

of the above requests can be addressed to Raiffeisen Bank as follows:

- To the attention of Responsible Person of Raiffeisen Bank Sh.a, to whom the claims on the reported data can be addressed.
- Name/Address: Mrs. Juljana Leka  
Rruga e Kavajës, Tiranë, Shqipëri
- Email: [rba.dataprotection@raiffeisen.al](mailto:rba.dataprotection@raiffeisen.al)
- Telephone: +355698022250
- Web page: <https://www.raiffeisen.al/>

9.5 We hereby declare that we have carefully read and understood the content of this prior consent clause and recognize the relevant legal consequences regarding the processing of our personal data, financial information and/or any other information about ourselves in the capacity of authorized representatives or ultimate beneficial owners of the Chargor and therefore I sign this document on my own full and free will.

9.6 This authorization is considered given to all signatory persons to the Agreement, so as for the Chargor's authorized representatives or ultimate beneficial owners and their data.

#### ARTICLE 10 MISCELLANEOUS

10.1 This Agreement is governed by and shall be construed in accordance with the laws of Albania.

10.2 The Chargor hereby authorizes the Chargee to register such notice of registration forms and other documents and do such acts as a Chargee may deem appropriate to complete and continue the Securing Charge, to protect and preserve the Security, and to enforce upon the Securing Charge, including but not limited to any transfer being made under the Senior Facilities Agreement to a New Lender.

10.3 This Agreement is entered into pursuant to the Senior Facilities Agreement and is binding on the signing parties, as well as the persons that may become their substitutes or to whom are transferred these rights and remedies.

10.4 The parties can amend only in written the elements of this Agreement and reflect them as well in the respective registries.

10.5 All disputes arising out of or in connection with this Agreement will be solved in understanding; in the contrary the Tirana District Court will be competent. Notwithstanding the foregoing, EBRD, is and shall not be subject to the jurisdiction of the Albanian courts by virtue of the immunities, privileges or exemptions of EBRD accorded under the Agreement



BERZH-it të akorduara në bazë të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, të ratifikuar nga Shqipëria nëpërmjet ligjit nr. 7525, datë 03.12.1991 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim".

10.6 Kjo Marrëveshje u nënshkrua në versionin në gjuhën shqipe dhe në versionin në gjuhën angleze në 4 (katër) kopje, me vlera të njëjta juridike; mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të palëve kontraktuese. Njëra kopje vendoset në arkivën noteriale, dy kopje i vihen në dispozicion Bankës, dhe nga një kopje palës tjetër kontraktuese. Në rast mospërputhesh ndërmjet dy versioneve, versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

Marrëveshja u lexua nga unë, Noteri publik, me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit.

Unë, Noteri, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të Ligjit për Noterinë, vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave, unë, Noteri, deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Marrëveshjeje, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**BARRËMARRËSI/AGJENTI I GARANCIVE  
RAIFFEISEN BANK SH.A.**

*Përfaqësuar nga:*

Znj. Vilma Baçe

Znj. Gledisa Buxhuku

**BARRËDHËNËS/GARANTUES:**

Shoqëria **ALBCHROME HOLDING SH.P.K.**

*Përfaqësuar nga:*

Z. Mehmet Şevket Erol

Establishing the European Bank for Reconstruction and Development, ratified by Albania through Law no. 7525, dated 03.12.1991 "For the adhesion of the Republic of Albania to the European Bank for Reconstruction and Development".

10.6 This Agreement was signed in the Albanian language version and in the English version in 4 (four) copies, with the same legal values; based on the free and full expression of the will of the contracting parties. One copy is placed in the notarial archive, two copies are made available to the Bank, and one copy to the other contracting party. In case of discrepancies between the two versions, the English language version will prevail.

The Agreement was read by me, the public Notary, aloud and clearly in the presence of the contracting parties, who declared that they understood its content and since it expresses their free and full will, since they recognized and understood its legal effects, they sign it regularly before me, the Notary.

I, the Notary, verified the identity of the contracting parties through identity documents and after I found the content of the above notarial deed, in full compliance with article 62, 63 of the Notary Law, certify their signing.

Pursuant to the Data Protection Law, I, the Notary, declare that I will preserve and process the personal data of the subjects of this Agreement, in a fair and lawful manner.

**CHARGE/SECURITY AGENT  
RAIFFEISEN BANK SH.A.**

*Represented by:*

Mrs. Vilma Baçe

Mrs. Gledisa Buxhuku

**CHARGOR/GUARANTOR:**

The company **ALBCHROME HOLDING SH.P.K.**

*Represented by:*

Mr. Mehmet Şevket Erol

**ALBCHROME**  
holding

IDENT: L51320005G

**ALBCHROME**  
holding





NOTERI

PRANUAR DHE KONFIRMUAR NGA:  
Shoqëria ALBCHROME SH.P.K.  
Përfaqësuar nga:

Z. Mehmet Şevket Erol

Mehmet Erol  
Mehmet Şevket EROL



PUBLIC NOTARY

ACCEPTED AND CONFIRMED BY:  
The company ALBCHROME SH.P.K.  
Represented by:

Mr. Mehmet Şevket Erol

Mehmet Erol  
Mehmet Şevket EROL



ALBCHROME holding  
SHOQËRIE TË RE  
NIPT: K11613001M

ALBCHROME holding